



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:185320
Datë: 28.01.2022
Numri i dokumentit: 02656351

Ac.nr.10083/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Faton Ademi kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Zenel Leku anëtarë, në çështjen juridike të paditëses/propozueses së masës së sigurimit D.Ç, nga Fushë Kosova, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson A.L dhe A.GJ avokatë nga Prishtina, kundër të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit A.Ç, M.Ç dhe F.Ç, të gjithë nga Prishtina, të cilët në bazë të autorizimit i përfaqësojnë A.E dhe O.M, avokat nga Prishtina, A.M, nga Prishtina, Rruga, ... të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve R..., me adresë në rrugën, ... Prishtinë me avokat F.S dhe E..., ... Prishtinë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson R.K avokat nga Prishtina, Rruga, ..., duke vendosur sipas ankesës së të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit A.Ç, M.Ç dhe F.Ç, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.238/18 të datës 12.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.01.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit A.Ç, M.Ç dhe F.Ç, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.238/18 të datës 12.10.2021, në pikën I dhe II të dispozitivit të aktvendimit VËRTETOHET.

II.Pika III, IV dhe V e aktvendimit të atakuar mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.238/18 të datës 12.10.2021, në pikën I (një) të dispozitivit të aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar propozimin e paditëses-propozueses së masë së sigurisë D.Ç, nga Fushë Kosova, ashtu që është caktuar masa e sigurisë dhe iu është ndaluar të paditurve/kundërshtarëve të masës së sigurimit M.Ç dhe F.Ç, të dy nga Prishtina, shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfarëdo barre-hipotekë në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-16-0, në sipërfaqe prej 79 m² e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-17-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-32-0, në sipërfaqe prej 79 m² e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-20-0, në sipërfaqe prej 79 m², e cila evidentohet në emër të F.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-21-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të F.Ç, të cilat njësi banesore janë të ndërtuara në ngastrën kadastrale 7588-5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4970 m², Zona Kadastrale Prishtinë.

Në pikën II (dy) të dispozitivit të aktvendimit janë detyruar të paditurit/kundërshtarët e sigurimit M.Ç dhe F.Ç që deri në përfundimin e këtij kontesti me vendim të formës së prerë, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate, të mos i shesin, tjetërsojnë, ngarkojnë me çfarëdo barre-hipotekë, paluajtshmëritë e cekura si në pikën I të këtij aktvendimi nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Në pikën III (tre) të dispozitivit të aktvendimit është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit së paditëses/propozueses së masës së sigurimit D.Ç, nga Fushë Kosova, me të cilin ka kërkuar që t'iu ndalohej të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit A.Ç, M.Ç dhe F.Ç, të gjithë nga Prishtina, shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfarëdo barre-hipotekë i ngastrës kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m², e cila gjendet në vendin e quajtur ..., e evidentuar në çertifikatën me njësi kadastrale P-71904059-06186-5, Zona Kadastrale Prishtinë, deri në përfundimin me vendim të plotfuqishëm të këtij kontesti, si i pa bazuar.

Në pikën IV (katër) të dispozitivit të aktvendimit është refuzuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit së paditëses-propozueses D.Ç, nga Fushë Kosova, me të cilin ka kërkuar që t'iu ndalohej të paditurit/kundërshtarit të sigurimit A.M nga Prishtina, shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfarëdo barre-hipotekë në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², e cila evidentohet në emër të A.M, deri në përfundimin me vendim të plotfuqishëm të këtij kontesti, si i pa bazuar.

Në pikën V (pesë) të dispozitivit të aktvendimit është vendosur që ky aktvendim tu dorëzohet palëve, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Pronësi në Prishtinë, dhe Kryetares së Odërs së Noterëve për Regjionin e Prishtinës.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor përmes përfaqësuesve të autorizuar kanë paraqitur ankesë të paditurit/kundërshtarët e sigurimit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën ashtu që ta anuloj aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja/propozuesja e sigurimit me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën e të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.238/18, të datës 12.10.2021 ta refuzoj si të pa bazuar ndërsa aktvendimin atakuarta vërtetoj.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi/propozuesi i masës së sigurimit ka ushtruar padi më datë 29.01.2018, ndaj të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, baza e kontestit ndarje e trashëgimisë, me arsye si në padi.

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin, C.nr.238/18, i datës 12.10.2021 ka vendosur që të aprovet propozimi i palës paditëse/propozueses të masës së sigurimit duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të saj ka theksuar se pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurisë është i bazuar. Gjykata tutje ka arsyetuar se sa i përket pjesës së aprovuar të masës së sigurimit, gjykata ka marrë në vlerësim posaçërisht këqyrjen e gjykatës në vend shikim dhe me ekspertizën e datës 18.08.2020, e punuar nga eksperti i gjeodezisë Q.H, ku ka vërtetuar se kundërshtarët e masës së sigurimit M.Ç dhe F.Ç, bashkëshortja e A.Ç evidentohen si pronar individual në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-16-0, në sipërfaqe prej 79 m² e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-17-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësitë kadastrale O-7588-5-1151-0-32-0, në sipërfaqe prej 79 m² e cila evidentohet në emër të M.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-20-0, në sipërfaqe prej 79 m², e cila evidentohet në emër të F.Çt, në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-21-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të F.Ç, të cilat njësi banesore janë të ndërtuara në ngastrën kadastrale 7588-5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4970 m², Zona Kadastrale Prishtinë.

Për pjesën e aprovuar të masës së sigurisë, gjykata ka marrë në vlerësim edhe pretendimet e të autorizuarës së pditëses-propozueses së sigurimit se pa caktimin e masës së sigurimit pditëses-propozueses së sigurimit do t'i pamundësohej realizimi i kërkesës nëse do të rezultonte se kërkesëpadia është e bazuar. Në këtë fazë të procedurës gjykata e ka pranuar pjesërisht si besueshme kërkesën për masë të sigurisë pavarësisht se besueshmëria e kërkesëpadiës do të varet nga një proces i thellë i shqyrtim dhe i vlerësimit të provave të cilat do të administrohen në shqyrtim kryesor. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet nga neni 297.1 nën (a) dhe (b) dhe në mbështetje të nenit 300 të LPK-së, u vendos si në pjesën e aprovuar.

Sa i përket ekzistimit të rrezikut se të paditurit M.Ç dhe F.Ç mund t'i shesin, tjetërsojnë, ngarkojnë me barrë-hipotek njësitë kadastrale O-7588-5-1151-0-16-0, në sipërfaqe prej 79 m² e

cila evidentohet në emër të M.Çt, O-7588-5-1151-0-17-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të M.Çt, O-7588-5-1151-0-32-0, në sipërfaqe prej 79 m² e cila evidentohet në emër të M.Çt, O-7588-5-1151-0-20-0, në sipërfaqe prej 79 m², e cila evidentohet në emër të F.Çt, O-7588-5-1151-0-21-0, në sipërfaqe prej 80 m², e cila evidentohet në emër të F.Ç, gjykata ka theksuar se ky rrezik ekziston sepse këto prona kanë kaluar në emër të kundërshtarëve të sigurimit dhe me vet faktin se me aktvendimin T.nr.331/2005, të datës 03.10.2005, gjyshi i propozueses A.Ç, nuk është përfshirë në trashëgimi, pastaj me kontratën për ndërtimin e përbashkët Vr.nr.191/2009, të datës 14.01.2009, e lidhur në mes të E... dhe M.Ç dhe U.Ç, me kontratën për ndarjen e pjeshme të njësive ndërtimore nga investimi i përbashkët dhe transferimin –bartjen e të drejtës së pronës nga investitori në fituesin Nr. i LRP/Ref.6377-797/2013, të datës 26.11.2013, është vërtetuar se E... sh.p.k si investitor dhe M.Ç dhe U.Ç si fitues ose pronar të tokës si dhe me kontratën për dhurimin e paluajtshmërive Nr.i LRP 3203/2014, Nr. Ref. 679/2014, të datës 16.05.2014, U.Ç si dhuratëdhënës i ka dhuruar M.Ç, A.Ç, F.Ç, S.A, E.A njësi banesore të ndërtuara në ngastrën kadastrale nr. 7588-5, në sipërfaqe prej 4970 m², dhe me kontratën për ndarjen e pjesëshme të njësive ndërtimore nga investimi i përbashkët dhe transferimin –bartjen e të drejtës së pronës nga investitori në fituesin Nr. i LRP/Ref.6377-797/2013, të datës 26.11.2013, ndërsa paditësja-propozuesja e masës së sigurimit Djellëza Çerkezi nuk është përfshirë në asnjë formë si trashëgimtare, e bënë evident rrezikun e shitjes, tjetërsimit, ngarkimit me barrë–hipotekë, me çka në këtë fazë të procedurës do të rrezikohej shkaktimi i ndonjë dëmi të pa kompensueshëm për propozuesen me çka do të humbej qëllimi dhe kuptimi i masës.

Gjykata e shkallës së parë për pjesën e refuzuar të propozimit për caktimin e masës së sigurimit me të cilin propozuesja ka kërkuar që t’iu ndalohej të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit A.Ç, M.Ç dhe F.Ç, të gjithë nga Prishtina, shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfarë do barre–hipotekë i ngastrës kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m², e cila gjendet në vendin e quajtur ..., e evidentuar në certifikatën me njësi kadastrale P-71904059-06186-5, Zona Kadastrale Prishtinë, deri në përfundimin me vendim të plotfuqishëm të këtij kontesti, ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimit pasi që me nenin 297 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, është e paraparë se “Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, apo në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.

Gjykata ka vlerësuar se paditësja-propozuesja e sigurimit ka dështuar ta bëjë të besueshme kërkesën për caktimin e masës së sigurisë në ngastrës kadastrale nr. 6186-5, pasi që nuk ka paraqitur asnjë arsyes bindëse me të cilën do të vërtetohet se të paditurit-kundërshtarët e sigurimit do të bënin shitjen e mundshme të ngastrës kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m² e cila kërkohet të sigurohet më masë të sigurimit.

Duke vendosur sipas propozimit për pjesën e refuzuar, e në kuptim të nenit 297 par. 1 pika b të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata e shkallës së parë pasi ka analizuar provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se nuk është plotësuar kushti i dytë dhe se nuk ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësoi apo vështirësoi dukshëm realizimin e kërkesës, pasi që gjykata duke e vlerësuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë gjeti se ngastra kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m², e cila gjendet në vendin e quajtur ..., e evidentuar në çertifikatën me njësi kadastrale P-71904059-06186-5, Zona Kadastrale Prishtinë edhe më tutje evidentohet në emër të A.Ç, rrethan kjo e vërtetuar me ekspertizën e gjeodezisë të datës 18.08.2020, e cila rrethanë nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

Andaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësja-propozuesja e sigurimit nuk e ka bërë të besueshme kërkesën për caktimin e masës së sigurisë edhe në pjesën e refuzuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi si dhe rrezikun se pa caktimin e masës paditësja-propozuesja e sigurimit nuk mund të realizoj kërkesën, kjo ngase gjykata nuk mund të ofroj mbrojtje gjyqësore duke u mbështetur në supozimet e paditëses-propozueses së sigurimit, se të paditurit-kundërshtarët e sigurimit mund ta shesin apo tjetërsojnë ngastraën kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m² pa pasur asnjë dëshmi se të njëjtit kanë filluar të shfaqin ndonjë pretendim për shitje apo tjetërsim të kësaj ngastre e cila ngastër evidentohet edhe më tutje në emër të gjyshit të propozueses e për të cilën ngastër nga shkresat e lëndës është vërtetuar se edhe më tutje nuk ka filluar ndonjë procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë nga pasardhësit e të ndjerit A.Ç.

Andaj, gjykata ka vlerësuar se refuzimi i masës së sigurimit në ngastrën kadastrale nr. 6186-5, në sipërfaqe prej 439 m², në asnjë mënyrë nuk e prejudikon vendosjen meritore të kërkesëpadisë dhe gjithashtu gjykata vlerëson se refuzimi i masës së sigurimit në asnjë mënyrë nuk e pamundëson realizimin e kërkesës së paditëses-propozueses së sigurimit, nëse e njëjta do të provohet si e bazuar.

Gjykata për pjesën e refuzuar të propozimit për caktimin e masës së sigurimit me të cilin ka kërkuar që t'i ndalohet të paditurit-kundërshtarit të sigurimit A.M nga Prishtina, shitja, tjetërsimi, ngarkimi me çfarëdo barre-hipotek në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², e cila evidentohet në emër të A.M, deri në përfundimin me vendim të plotfuqishëm të këtij kontesti, ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimit pasi që në plotësimin e ekspertizës së gjeodezisë së datës 19.07.2021, e punuar nga eksperti Q.H, është konstatuar se njësia kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², e cila evidentohet në emër të A.M, evidentohet pronësi individuale, e cila sipas Aktvendimit nr. 011-952-3884, të datës 18.12.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit në Prishtinë, njësia banesore O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², ka kaluar në emër të A.M, duke u bazuar në kontratën mbi dhurimin e patundshmërisë të lidhur në mes të XH.M si dhuratdhënës e cila kontratë është e vërtetuar me VR,nr.1041/2012, datë 28.03.2012, që nuk ka qenë kontestuese kontestuese nga ana e palëve në procedurë.

Gjykata duke e vlerësuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë në raport me njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², gjeti se kërkesa e propozimit është

identike më kërkesën e padisë e që i referohet ndalimit të tjetërsimit, shitjes, ngarkimi me çfarëdo barre-hipotek, pronë e të paditurit A.M.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vendosur të refuzoj kërkesën për caktimin e masë së sigurimit në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², pasi që kërkesa e padisë në raport me të paditurin-kundërshtarin e sigurimit A.M është identike më kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, që do të thotë se nëse gjykata do ta pranonte kërkesën e propozueses për caktimin e masës së sigurimit, në fakt do të përfshinte me masë të sigurimit kërkesën që sigurohet, gjë që do të ishte në kundërshtim më rregullin e mos prejjudikimit të vendosjes meritore të kërkesëpadisë. Gjykata nuk ka mundur në këtë rast ta pranoj kërkesën për caktimin e masës së sigurisë pasi që vendosja e masës së sigurisë në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², në radhë të parë do të përfshinte në vendimin për masë kërkesën e padisë që pretendohet të sigurohet me masë, së dyti pranimi i propozimit për caktimin e masës së sigurisë do të nënkuptohej si vendosjes e pjesëshme e kërkesëpadisë dhe së treti do e prejjudikonte vendosjen e pjesës tjetër të kërkesëpadisë.

Gjykata ka vlerësuar se propozimi për caktimin e masës së sigurimit në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², i referohet masave nga nenit 300 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, e që sipas dispozitës së nenit 300.3 duhet të refuzohet.

Gjykata ka vlerësuar se propozuesi i masës së sigurimit ka dështuara ta bëjë të besueshme kërkesën për caktimin e masës së sigurisë pasi që nuk ka paraqitur asnjë arsyes bindëse me të cilën do të vërtetohet se kundërshtari i sigurimit do të bënin shitjen e mundshme të njësisë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², e cila kërkohet të sigurohet me masë të sigurimit.

Tutje Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se refuzimi i masës së sigurimit në njësinë kadastrale O-7588-5-1151-0-23-0, në sipërfaqe prej 58 m², në asnjë mënyrë nuk e prejjudikon vendosjen meritore të kërkesëpadisë së paditëses-propozueses së sigurimit dhe gjithashtu gjykata vlerëson se refuzimi i caktimit të masës së sigurimit në këtë njësi banesore në asnjë mënyrë nuk e pamundëson realizimin e kërkesës së paditëses-propozueses së sigurimit, nëse e njëjta do të provohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në ankesën e parashtruar të paditurit/kundërshtarët e sigurimit kanë theksuar se gjykata ka bërë shkelje nga neni 297 i LPK-s, sepse në asnjë mënyrë nuk është rrezikuar apo pamundësuar realizimi i kërkesës së propozueses së masës së sigurimit, duke theksuar se kjo masë është

caktuar në paluajtshmëritë e personave të cilët nuk janë në bashkësi familjare me propozuesen konform nenit 271 të Ligjit për Familjen. Tutje në ankesë shton se gjykata gjithmonë duhet të bazohet në shembullin kur propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm pretendimin se masa e sigurisë është e bazuar duke paraqitur vendimin apo titullin juridik lidhur me të, çka në rastin konkret gjykata nuk ka vepruar drejtë ngase një masë të tillë ka mundur ta caktoj vetëm në ngastrën kadastrale e cila është evidentuar në emër të A.Çt, gjyshit të propozueses.

Duke i vlerësuar pretendimet e mësipërme ankimore, Gjykata e Apelit vlerëson se këto pretendime nuk janë të themelta. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, për faktin se pas vlerësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, edhe Gjykata e Apelit ka gjetur se plotësohen kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së për caktimin e masës së sigurimit. Neni 297.1 pika a) përcakton se: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij”*. Në rastin konkret paditësja/propozuesja e masës së sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të saj me provat e dorëzuara e te cilat prova janë vlerësuar vetëm në raport me themelësinë e propozimit për masë po jo në themelësinë e kërkesëpadisë, sepse në këtë fazë gjykata nuk ka drejtë të nxjerr një vlerësim të tillë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor, se gjykata e shkallës së parë është bazuar vetëm në deklaratimet e propozueses së masës, për arsye se nga shkresat e lëndës kjo Gjykatë vëren se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë edhe ekspertizën e gjeodezisë, ka dalë në vendin e ngjarjes, dhe edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në bazë të këtyre provave është vërtetuar e drejta subjektive e paditëses/propozueses së masës së sigurimit, dhe se provat aktuale pra, vlerësohen vetëm në kuptim të vërtetimit të plotësimin të kushteve për lëshimin e masës.

Vendimi për masë të sigurisë është vendim përmes të cilit sigurohet ruajtja e gjendjes ekzistuese, nga ndryshimi eventual që kanoset se mund ta ndryshoj një gjendje të tillë, dhe se aprovimi apo refuzimi i një propozimi për caktim të masës së sigurimit nuk nënkupton aprovimin apo refuzimin e kërkesëpadisë.

Vendimi në fjalë nuk nënkupton se medoemos do të ndikoj në themelësinë e kërkesëpadisë, mirëpo tani për tani ky vendim është i mjaftueshëm që të ndikojë në përmbushjen e kushtit nga pika a) e nenit 297 të LPK-së, sepse me këtë vendim bëhet e besueshme se ekziston kërkesa apo e drejta subjektive e propozueses së masës së sigurimit, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës.

Përveç pikës a), nga neni 297 par.1 i LPK-së, Gjykata e Apelit vlerëson se ekzistojnë edhe shkaqet nga pika b) e nenit të sipërcituar i cili përcakton se: *“Në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet. Me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, kjo për arsye se ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, edhe kjo Gjykatë e mbështet qëndrimin e gjykatës së shkallës më të ulët duke vlerësuar se meqenëse

paditësja/propozuesja e masës së sigurimit nuk është përfshirë askund si trashëgimtare, ekziston rreziku që paluajtshmëritë kontestuese të shiten nga ana e të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit, apo që të njëjtat të tjetërsohen apo të ngarkohen me barrë apo hipotekë, ashtu që do të krijohej gjendje e vështirë që paditësja/propozuesja e masës së sigurimit të realizonte kërkesën e saj, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se është e nevojshme caktimi i masës së sigurimit në mënyrë që të parandalohet dëmi që mund tu vijë të drejtave të paditëses/propozueses së masës dhe të sigurojë që procesi gjyqësor të mund të arrijë një rezultat të dobishëm sepse caktimi i masës së sigurisë synon që ta mbajë gjendjen ashtu siç është deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, pa paragjykuar zgjidhjen e çështjes apo themelësinë e kërkesëpadisë.

Pra, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka aprovuar propozimin e palës paditëse/propozueses së masës së sigurimit, dhe Gjykata në procedurën e masës së sigurimit nuk lëshohet në themelësinë –bazueshmërinë e provave dhe argumentimit të tyre në raport me kërkesëpadinë, por vlerësimi i tyre është vetëm në kuptim të plotësisimit të kushteve të caktimit të masës.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendosjes ndryshe nga ajo që është vendos në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10083/21, me datë 25.01.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Ademi